

Si u parandalua vrasja/ Vëllezërit zihen për pronën, plagoset mbesa. Nipi rrëmben armën dhe...

Nov 17, 2019 | 16:46

ETLEVA DELIA/ Konfliktet e pronësisë vazhdojnë të shkaktojnë përplasje të rënda, madje edhe mes vëllezërve e fëmijëve të tyre.



Një ngjarje e rëndë u arrit të parandalohet në kohë nga Policia dhe në Pezë, pasi mund të rezultonte me pasoja fatale, deri në vrasje. Dy vëllezër janë konfliktuar me njëri-tjetrin për pronën në fshatin Maknor të Pezës e për pasojë ka mbetur e plagosur lehtë vajza e njërit prej tyre.

Ndërsa djali i vëllait tjetër ka qëlluar me armë drejt makinës së xhaxhait. Fatmirësisht, ngjarja u mbyll pa pasoja të rënda dhe shërbimet e Komisarariatit Nr.6 arrestuan 58-vjeçarën Petrit S., i cili dyshohet se i ka shkakuar dëmtime gjatë përleshjes mbesës së tij, vajzës së vëllait.

Nga ana tjetër, Policia tha dhe se ka shpallur në kërkim djalin e të arrestuarit, 20-vjeçarën Endri S., si autor i dyshuar për shkatërrimin e makinës së xhaxhait të tij me armë zjarri, por edhe për kanosjen e tij, po me armë.

NGJARJA

Te lidhura




Moti i keq në vend/ Problematika serioze në Jug si dhe Lezhë e Shkodër, Policia ka një apel për qytetarët: Shmangni lëvizjet në...

Moti i keq në Itali/ Rrëshqitje dherash në vend parkimin e spitalit COVID, disa makina përfundojnë në gropën 20 metra të thellë



Suksesi i fermave shqiptare bind Fevziun të veshë çizmet e bujqësisë



Mia Malkova, një tifoze me "pullë të kuqe" për Mançester Junajtid

Policia e Tiranës tha dje se reagimi në kohë i shërbimeve të Komisarariatit nr.6 parandaloi përshkallëzimin e një konflikti me të rënda. Policia arriti të arrestojë një 58-vjeçar, i cili, gjatë konfliktit për motive pronësie me të vëllain, dhunoi fizikisht mbesën.

Ndërsa u bë shpallja dhe në kërkim e djalit të 58- vjeçarit, i cili gjatë konfliktit dëmtoi mjetin e xhaxhait, duke e qëlluar me armë zjarri. Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr.6 arrestuan në flagrancë shtetasin Petrit S., 58 vjeç, banues në fshatin Maknor, në Pezë të Tiranës.

Policia tha zyrtarisht dje se, në fshatin Maknor, i arrestuari Petrit S. është konfliktuar për motive pronësie me vëllain e tij, shtetasin Xhevdet S. dhe gjatë konfliktit ka dhunuar fizikisht mbesën e tij, vajzën e Xhevdetit, duke i shkaktuar lëndime në trup. Gjithashtu, është shpallur në kërkim dhe po punohet intensivisht për kapjen e djalit të tij, shtetasit Endri S., i cili gjatë konfliktit ka thyer xhamat e mjetit të xhaxhit, shtetasit Xhevdet S., pasi ka qëlluar në drejtim të mjetit me armë zjarri.

Materialet procedurale iu referuan për veprime të mëtejshme Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për veprat penale ‘Dhunë në familje’ në ngarkim të shtetasit Petrit S. dhe veprat penale ‘Shkatërrim prone’, ‘Kanosje’, ‘Prishje e qetësisë publike’ dhe ‘Mbajtja pa leje e armëve’, në ngarkim të shtetasit Endri S.”, tha zyrtarisht Policia e Tiranës.

NJOFTIMI I POLICISË

“Reagimi në kohë i shërbimeve të Komisarariatit të Policisë Nr.6 parandalon përshkallëzimin e një konflikti me pasoja të rënda. Policia vë në pranga një 58-vjeçar, i cili, gjatë konfliktit për motive pronësie me të vëllain, dhunoi fizikisht mbesën. Shpallet dhe në kërkim djali i 58-vjeçarit, i cili gjatë konfliktit dëmtoi mjetin e xhaxhait, duke e qëlluar me armë zjarri. Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr.6 arrestuan në flagrancë shtetasin P. S., 58 vjeç, banues në fshatin Maknor, në Pezë Tiranë.

Në fshatin Maknor, ky shtetas është konfliktuar për motive pronësie me vëllain e tij, shtetasin Xh. S., dhe gjatë konfliktit ka dhunuar fizikisht mbesën e tij (vajzën e shtetasit Xh. S.), duke i shkaktuar lëndime në trup. Gjithashtu, është shpallur në kërkim dhe po punohet intensivisht për kapjen e djalit të tij, shtetasit E. S., i cili gjatë konfliktit ka thyer xhamat e mjetit të xhaxhit (të shtetasit Xh. S.), pasi ka qëlluar në drejtim të mjetit me armë zjarri”, tha dje zyrtarisht Policia.

© **Panorama.al**

Subscribe

Për t’u bërë pjesë e grupit të "**Panorama**" mjafton të klikoni: **Join Group** dhe kërkesa do t’ju aprovohet.

KOMUNITETI PANORAMA ONLINE:

<https://facebook.com/groups/panoramaonline/>

A do të marrë pjesë në inagurimin e Biden? Donald Trump e ka ndarë mendjen, ja çfarë ka vendosur